



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -052

PËR ENERGJINË TERMIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR ENERGJINË TERMIKE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë termike për ngrohje/ftohje të përqendruar, sipas ekonomisë së tregut të lirë, plotësimit të kërkesës së konsumatorit dhe mbrojtjes së mjedisit, furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient me energji termike, për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial konsumatorët që të gëzojnë të drejtë për t'u kyçur në sistemet e energjisë termike dhe për t'u furnizuar me energji termike sipas standardeve dhe me çmim ekonomik.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën Nr. 2009/28/EC lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Neni 2 Fushëveprimi

Me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe standardet për kryerjen e aktiviteteve energjetike të prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike, përmes sistemeve qendrore të energjisë termike, organizimin e tregut të energjisë termike dhe qasjen në rrjet, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që veprojnë sipas këtij ligji.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Bashkëprodhimi** - procesi i prodhimit të njëkohshëm të energjisë elektrike dhe termike nga një burim energjetik gjatë të njëjtit proces teknologjik;

1.2. **Certifikata e origjinës** – dokument i formës elektronike, që lëshohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që ka funksionin e shitjes, me qëllim të ofrimit si provë tek konsumatori fundor që një pjesë e caktuar e energjisë termike është prodhuar nga burimet e ripërtëritshme;

1.3. **Çmimi i parregulluar** - çmimi që i ngarkohet konsumatorit për ofrimin e shërbimeve standarde, siç përcaktohet në kontratë.

1.4. **Energji termike** – energjia për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial, që transportohet dhe shpërndahet përmes ujit, avullit, ose gazrave, e përfituar nga stabilimentet e energjisë termike, duke përdorur lëndët djegëse, burimet gjeotermale, energjinë solare, energjinë termike të pashfrytëzuar, me të cilën furnizohen konsumatorët përmes sistemeve qendrore të energjisë termike;

1.5. **Energji termike e pashfrytëzuar** –energjia termike e prodhuar në impiantet e proceseve teknologjike dhe termocentrale, e cila nuk shfrytëzohet, respektivisht është e humbur, e që me rritje të efikasitetit të proceseve, ka mundësi të përdoret për ngrohje/ftohje;

1.6. **Energjia termike nga mbeturinat** – energjia termike e fituar me djegien e mbeturinave që mund të përdoren për ngrohje/ftohje;

1.7. **Fluidi-bartës i energjisë termike** – uji i ngrohët, avulli, avulli i ngopur, lëngjet e tjera ose gazrat që përdoren për të transportuar energjinë termike përmes rrjetit të shpërndarjes;

1.8. **Furnizim** – shitja përfshirë rishitjen e energjisë termike tek konsumatorët;

1.9. **Furnizuesi publik** – ndërmarrja e energjisë termike e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të kryer veprimtarinë e furnizimit publik;

1.10. **Furnizimi publik** – furnizimi i konsumatorëve fundorë me energji termike me tarifa të rregulluara në pajtim me këtë ligj;

1.11. **Furnizuesi** – ndërmarrja e energjisë termike të licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit;

1.12. **Kodi i shpërndarjes** – përmbledhje e rregullave teknike dhe procedurave për operimin, mirëmbajtjen, planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, si dhe kyçjen në sistemin e shpërndarjes së energjisë termike;

1.13. **Kodi i matjes** – përmbledhje e rregullave dhe procedurave që përcaktojnë mënyrën e leximit të njehsorëve (matësve), llogaritjes së energjisë termike të shpenzuar dhe faturimit në sektorin e energjisë termike;

1.14. **Konsumator** – person juridik ose fizik që furnizohet me energji termike, në këtë mënyrë konsumatori mund të jetë ose përdoruesi i fundit, ose një person fizik apo juridik që furnizon me energji termike konsumatorin e fundit;

1.15. **Konsumatori fundor** - shpenzuesi i energjisë termike për përdorim vetanak;

1.16. **Konsumator me prioritet furnizimi** – konsumatori që ka prioritet në furnizim me energji termike siç janë spitalet, shkollat dhe çerdhet, si dhe institucionet tjera që mund të rregullohen me akt nënligjor;

1.17. **Licencë** – dokument i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që mundëson bartësit të licencës të ushtrojë aktivitete në sektorin e energjisë për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë;

1.18. **Ministria** – Ministria përkatëse për sektorin e energjisë.

1.19. **Ndërmarrjet e energjisë termike** – subjekti që përmbush një ose më shumë aktivitete të prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike, bazuar në licencën e dhënë, ashtu si dhe prodhuesit e energjisë termike që janë të kyçur në sistemin e energjisë termike, e që janë të përjashtuar nga licenca, siç përcaktohet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;

1.20. **Nënstacioni i energjisë termike** – qark pajisjesh për qarkullim dhe rregullim të dërgimit të energjisë termike, pa shkëmbyes të energjisë termike, i cili është pjesë përbërëse e instalimeve të brendshme të konsumatorëve fundor dhe është e vendosur brenda ndërtesës;

1.21. **Ngrohje/ftohje e përqendruar** – energjia termike që transportohet përmes fluidit-bartës të energjisë termike nga prodhuesi deri tek konsumatori, përmes rrjetit të shpërndarjes, për qëllim të ngrohjes/ftohjes së hapësirave të banimit dhe afariste në nivelin e kërkuar, si dhe ngrohjen e ujit sanitar dhe industrial;

1.22. **Ndërmarrje e energjisë termike vertikalisht e integruar** – ndërmarrja e energjisë termike që kryen prodhimin, transportimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji termike;

1.23. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** - personi juridik ose fizik i licencuar, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike;

1.24. **Pajisjet matëse** – instrumente të regjistruara në regjistrin e pajisjeve matëse të certifikuara në Republikën e Kosovës, që përdoren për matje të energjisë së prodhuar, transmetuar, shpërndarë, furnizuar dhe të konsumuar;

1.25. **Pika furnizuese** – nënstacioni termik prej të cilit fluidi-bartës i energjisë termike, eventualisht edhe uji i ngrohtë sanitar, i dërgohet konsumatorit fundor, ku bëhet matja e furnizimit me energji termike, me pajisje matëse përkatëse;

1.26. **Prodhimi i energjisë termike** – prodhimi i energjisë termike nga një ndërmarrje e licencuar për këtë aktivitet;

1.27. **Prodhuesi** – person juridik ose fizik që prodhon energji termike;

1.28. **Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike** – sistemi i tubacioneve, që transportojnë dhe shpërndajnë energjinë termike nga prodhuesi deri tek nënstacionet termike (prej vendit të matjes së energjisë termike të pranuar, deri tek vendi i matjes së energjisë termike për furnizim respektivisht nënstacionet termike dhe njehsorëve të energjisë termike);

1.29. **Rrjeti sekondar i energjisë termike** – sistemi i tubacioneve si dhe pajisjet përcjellëse që shpërndajnë energjinë termike nga vendi i matjes së energjisë termike për furnizim, respektivisht nënstacioni, deri tek konsumatori fundor;

1.30. **Sistemi i energjisë termike** – sistemi teknik i përbërë nga stabilimente dhe pajisje për prodhimin e energjisë termike, nga instalimet e brendshme dhe të jashtme, që mundësojnë furnizimin me energji termike dhe mund të jetë i pavarur, i mbyllur, ose sistem qendror i energjisë termike;

1.31. **Sistemi i pavarur i energjisë termike** - sistemi i energjisë termike i cili përbëhet nga kaldatorja, njehsorët e energjisë termike dhe instalime të brendshme, të cilat i menaxhon dhe mirëmban konsumatori i energjisë termike;

1.32. **Sistemi i drejtëpërdrejtë i energjisë termike** - është sistemi termik i cili mund të përfshijë më shumë ndërtesa industriale/komerciale ose banimi, objektet që kanë një sistem të përbashkët të energjisë termike, për të cilat nuk është e nevojshme marrëveshje për koncesion;

1.33. **Sistemi qendror i energjisë termike** – sistemi i ndërlidhur i prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike që përcaktohet në nenin 4 të këtij ligji;

1.34. **Sezoni i ngrohjes/ftohjes** – periudha e furnizimit të konsumatorëve me energji termike, varësisht nga temperatura e jashtme, i cili është i përcaktuar sipas rregullave të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

1.35. **Stacioni termik** - është pjesë e rrjetit të shpërndarjes, e cila përdoret për transformimin, rregullimin, ose qarkullimin e mediumit për transmetimin e energjisë termike;

1.36. **Shpërndarje** – procesi i transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike përmes rrjetit të tubacioneve tek nënstationet termike të konsumatorëve;

1.37. **Tarifa normative** - sistemi i përkohshëm tarifor të energjisë termike të llogaritur për metër katror të sipërfaqes së ngrohur/ftohur;

1.38. **Tarifa me matje** – sistemi i përhershëm tarifor që bazohet në sasinë e shpenzuar të energjisë termike, të matur në pikën furnizuese, nga e cila furnizohet konsumatori;

1.39. **Tubacioni i drejtpërdrejtë i energjisë termike** – tubacioni i ngrohjes/ftohjes së përqendruar që lidh drejtpërdrejt objektet e prodhuesit me konsumatorin;

1.40. **Ujë i ngrohtë sanitar** – uji i ngrohtë për amvisëri, të ngrohur së paku deri në temperaturën e përcaktuar sipas normave higjienike;

1.41. **Zyra e Rregullatorit për Energji** – është agjenci e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Gazin Natyror.

KREU II

SISTEMI QENDROR I ENERGISË TERMIKE

Neni 4

Sistemi Qendror i energjisë termike

1. Sistemi qendror i energjisë termike përfshin njësinë e prodhimit të energjisë termike nga ndërmarrja përkatëse e licencuar, duke përfshirë termocentralet që prodhojnë energji termike nga bashkëprodhimi dhe rrjetin e shpërndarjes deri tek pika e furnizimit të konsumatorëve.
2. Prodhuesit, duke përfshirë termocentralet që operojnë si njësi të bashkëprodhimit mund të furnizojnë me energji termike, rrjetin e njëjtë për shpërndarje të energjisë termike.
3. Komuna është përgjegjëse për hartimin e planeve dhe projekteve për zhvillimin e sektorit të energjisë termike brenda territorit të saj.

Neni 5

Aktivitetet në sektorin e energjisë termike

Aktivitetet në sektorin e energjisë termike, të përcaktuara me këtë ligj, kryhen në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe akteve tjera nënligjore përkatëse të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Neni 6

Sthurja

1. Ndërmarrjet e energjisë termike të integruara vertikalisht kryejnë aktivitetin e prodhimit, transportimit dhe shpërndarjes, si dhe furnizimit me funksione të ndara. Bartja e informatave ndërmjet këtyre aktiviteteve të ndara është e ndaluar, përveç nëse këto informata kërkohen për përmbushjen e detyrave të furnizuesit publik.
2. Ndërmarrjet e energjisë termike të licencuara për aktivitetin e prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit ndajnë llogaritë e tyre të brendshme me qëllim të shmangies së diskriminimit, si dhe çrregullimit të konkurrencës.
3. Ndërmarrjet e energjisë termike të integruara vertikalisht mbajnë kontabilitet të ndarë veçmas për aktivitetet e furnizimit të konsumatorëve me tarifa të rregulluara dhe me çmime të parregulluara, si dhe për aktivitete që nuk kanë të bëjnë me energji termike.

KREU III

PRODHIMI I ENERJISË TERMIKE

Neni 7

Prodhimi i energjisë termike

Prodhimi i energjisë termike kryhet nga ndërmarrjet e energjisë që posedojnë licencë për prodhim të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, ose nga persona juridik apo fizik që janë të liruar nga detyrimi për t'u pajisur me licencë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 8

Të drejtat e prodhuesit të energjisë termike

1. Prodhuesi i energjisë termike ka të drejtë :

- 1.1. të shfrytëzojë gjatë procesit të prodhimit të energjisë termike, ato burime primare të energjisë, që i konsideron të përshtatshme, me kusht që të jenë në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet teknike, teknologjike, mjedisore dhe të eficiencës së energjisë;

1.2. që stabilimentet përkatëse t'i kyçë në rrjetin e shpërndarjes sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe rregullat dhe kodet përkatëse të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

1.3. të lidhë kontratë për shitjen e energjisë termike sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

1.4. të transportojë energjinë termike përmes rrjetit të shpërndarjes; dhe

1.5. të pajiset me njehsorë për matjen e energjisë termike, që hyn në rrjetin e shpërndarjes, të përcaktuara në Kodin e Matjes, si dhe të faturojë dhe arkëtojë pagesat e përcaktuara sipas kontratave për të gjitha shitjet e energjisë termike.

Neni 9

Obligimet e prodhuesit të energjisë termike

1. Prodhuesi i energjisë termike është i obliguar të:

1.1. ushtrojë veprimtarinë në pajtim me kushtet e licencës të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë si dhe ligjet tjera përkatëse;

1.2. ushtrojë veprimtarinë në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim që të sigurojë kontroll të përhershëm mbi ndikimin në mjedis;

2. Për matjen e energjisë termike, prodhuesit përdorin pajisjet matëse përkatëse, sipas kërkesave teknike dhe kërkesave tjera të përcaktuara në Kodin e Matjes.

3. Prodhuesi i energjisë termike me kapacitet të instaluar më shumë se 1 MWt, do t'i mbajë të dhënat për çdo orë të operimit të impiantit për një periudhë pesë (5) vjeçare. Këto të dhëna përfshijnë, të dhënat për kapacitetet prodhuese në dispozicion dhe rezervat e dedikuara, duke përfshirë kohën dhe sasinë e realizimit të prodhimit, por duke mos u kufizuar vetëm në to.

Neni 10

Obligimet e prodhuesve për të ofruar energji termike

Prodhuesit e energjisë termike me kapacitet më shumë se 1 MWt, të cilët ekzistonin dhe ishin në operim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të shesin energjinë termike të prodhuar furnizuesit publik me tarifa të rregulluara në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, në rast se furnizuesit publik i nevojitet ajo energji për të përmbushur obligimet e veta si furnizues publik.

Neni 11

Rezervat e lëndëve djegëse

1. Prodhuesi i energjisë termike i ngarkuar me obligim të shërbimit publik, duhet të mbajë rezerva minimale të lëndës djegëse të nevojshme për të mbajtur prodhim të vazhdueshëm dhe

në rast nevoje të shtojë kapacitetin prodhues rezervë në mënyrë që të sigurojë furnizim të qëndrueshëm për konsumatorët.

2. Shpenzimet e mbajtjes së minimumit të rezervave të lëndës djegëse dhe të kapacitetit prodhues rezervë trajtohen shpenzim operativ i prodhuesit që ka obligim t'i mbajë ato rezerva.

3. Ministria nxjerrë akt nënligjor lidhur me llojin dhe sasinë e rezervave minimale të lëndës djegëse, ose të kapacitetit prodhues rezervë.

KREU IV

ENERGJIA TERMIKE E PASHFRYTËZUAR, BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË DHE BASHKËPRODHIMI

Neni 12

Energjia termike e pashfrytëzuar, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimi

1. Ndërmarrja e energjisë termike që shfrytëzon energjinë termike të pashfrytëzuar, nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, ose mbeturinat, si dhe bashkëprodhimin e energjisë termike dhe energjisë elektrike, ka të drejtë të kërkojë certifikatën e origjinës nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

2. Furnizuesi publik i jep përparësi blerjes së energjisë termike për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës, me kusht që kostoja e energjisë termike nuk e ngrit çmimin e ngrohjes në nivel të paqëndrueshëm.

3. Nga furnizuesi publik kërkohet të blejë tërë sasinë e energjisë termike me çmim të rregulluar për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës për të plotësuar nevojat e konsumit të ngrohjes, me përjashtim të çfarëdo sasive për të cilën prodhuesi ka lidhur kontratë sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Zyra e Rregullatorit për Energji realizon aranzhime për të kompensuar shpenzimet shtesë me të cilat përballet furnizuesi publik për shkak të blerjes së energjisë termike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Neni 13

Certifikata e origjinës

1. Me kërkesë të prodhuesit, Zyra e Rregullatorit për Energji lëshon certifikatën e origjinës e cila:

1.1. certifikon kapacitetin e prodhuesit të energjisë termike që shfrytëzon burimet e ripërtëritshme të energjisë, mbeturinat urbane, bashkëprodhimin të energjisë termike dhe elektrike, si dhe energjinë termike të pashfrytëzuar;

1.2. përcakton afatet për dorëzimin e informatave dhe deklaratave tek Zyra e Rregullatorit për Energji.

Neni 14

Masat për prodhimin e energjisë termike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë

1. Ministria, me akt nënligjor përcakton masat për prodhimin e energjisë termike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, përfshirë caqet për prodhimin e energjisë termike duke përdorur, burimin e ripërtëritshëm të energjisë apo mbeturinat dhe bashkëprodhimin e energjisë termike dhe elektrike, si dhe energjinë termike të pashfrytëzuar, si përqindje e prodhimit total vjetor për secilin prodhues gjatë një periudhe dhjetë (10) vjeçare.

2. Zyra e Rregullatorit për Energji vendosë kushte të veçanta dhe të favorshme për blerje me prioritet të energjisë termike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimin të energjisë elektrike dhe energjisë termike duke marrë parasysh që çmimi i energjisë termike të jetë në nivel të arsyeshëm dhe të përballueshëm për konsumatorët.

KREU V

SHPËRNDARJA E ENERJISË TERMIKE

Neni 15

Përgjegjësitë e operatorit të sistemit të shpërndarjes

1. Për rrjetin e shpërndarjes përkujdeset Operatori i Sistemit të Shpërndarjes që posedon licencë për kryerjen e aktiviteteve të shpërndarjes së energjisë termike.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, për territorin e caktuar dhe të mbuluar nga rrjeti i shpërndarjes kryen, shërbimet si në vijim:

2.1. menaxhon rrjetin e shpërndarjes;

2.2. mirëmban rrjetin dhe objektet në pajtim me kërkesat teknike;

2.3. harmonizon projektet e veta me projektet për zhvillim ekonomik dhe urban të komunës;

2.4. parashikon kërkesat për energji termike në harmoni me projektet e veta për zhvillim ekonomik dhe urban të komunës;

2.5. transporton në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurt energjinë termike përmes rrjetit të shpërndarjes;

2.6. informon shfrytëzuesit e rrjetit me informata që iu nevojiten për qasje efikase në rrjet, si dhe shërbime tjera përkatëse.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në kuadër të veprimtarisë së vet kryen edhe:

- 3.1. shqyrtimin e planit për projekte të zgjerimit të rrjetit të shpërndarjes në pajtim me parametrat e zhvillimit ekonomik dhe urban të komunës;
 - 3.2. përgatit plane vjetore afatshkurta dhe afatgjata të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes dhe koordinon projekte me Ministrinë dhe komunat;
 - 3.3. bashkëpunon me Ministrinë dhe komunat në përgatitjen e planeve, programeve dhe strategjive zhvillimore;
 - 3.4. vë në dispozicion të ndërmarrjeve prodhuese të energjisë termike, planet dhe analizat e veta studimore.
4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lejon prodhuesin tjetër të energjisë termike që të kyçet në sistemin e rrjetit të shpërndarjes nëse janë plotësuar kushtet teknike, si dhe kërkesat tjera të parapara me dispozitat e këtij ligji dhe akteve tjera përkatëse.
 5. Zgjerimi dhe rindërtimi i rrjetit të shpërndarjes të energjisë termike që nga pika e furnizimit deri tek prodhuesi i energjisë termike është nën përgjegjësinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
 6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kyçë në rrjetin e shpërndarjes cilindro prodhues që prodhon energji termike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit.
 7. Kushtet dhe procedurat për kyçje në rrjetin e shpërndarjes rregullohen me kodin e shpërndarjes.
 8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes vepron në pajtim me procedurat transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në parimet e ekonomisë së tregut.
 9. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes obligohet të bëjë instalimin e pajisjeve matëse të ngrohjes të cilat mundësojnë leximin e rregullt të konsumit të energjisë.

Neni 16

Ruajtja e informatave

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ruan fshehtësinë e informatave me ndjeshmëri komerciale të siguruara gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre, si dhe pengon zbulimin në mënyrë diskriminuese të informatave për aktivitetet e veta të cilat mund të sigurojnë përparësi komerciale.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria apo Zyra e Rregullatorit për Energji mund të kërkojnë nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes informacione të domosdoshme për t'i zbatuar funksionet, autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

KREU VI FURNIZIMI ME ENERGJI TERMIKE

Neni 17 Aktiviteti i furnizimit me energji termike

1. Furnizimi me energji termike është aktivitet i shitjes dhe rishitjes së energjisë termike për konsumatorët.
2. Furnizimi me energji termike kryhet nga furnizuesi publik, furnizuesit tjerë dhe prodhuesit e energjisë termike.

Neni 18 Furnizimi publik

1. Furnizimi i konsumatorëve me energji termike bëhet nga furnizuesi publik i cili posedon licencë përkatëse të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
2. Furnizuesi publik kryen obligimin e shërbimit publik të furnizimit me energji termike të konsumatorëve me tarifa të rregulluara, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 19 Të drejtat dhe përgjegjësitë e furnizuesit publik

1. Furnizuesi publik ka të drejta dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1 që ekskluzivisht t'i furnizojë konsumatorët me energji termike me tarifa të rregulluara, sipas kushteve dhe kërkesave të licencës të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.2 të blejë energji termike me tarifa të rregulluara nga prodhuesit e energjisë termike në pajtim me nenin 10 të këtij ligji dhe në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.3 të blejë energji termike nga prodhues tjerë me çmime të parregulluara;
 - 1.4 të përgatisë dhe dorëzoj faturat si dhe të arkëtojë pagesat nga konsumatorët e vet;
 - 1.5 të blejë me prioritet energjinë termike për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës nga Zyra e Rregullatorit për Energji, sipas rregullave të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji;
 - 1.6 të krijojë, mekanizmat e nevojshëm për përkrahjen e konsumatorëve në nevojë në konsultim me Zyrën e Rregullatorit për Energji;

1.7. të përgatis, dorëzoj faturat si dhe arkëtoj pagesat nga konsumatorët e tij dhe ndërmarrjet tjera energjetike. Ky faturim dhe inkasim monitorohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë apo ligjet tjera të aplikueshme, si dhe licencat, kodet apo rregullat që lëshohen nga to.

2. Kur furnizuesi publik është përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji si furnizuesi i alternativës së fundit ai ka për obligim të kryej këto detyra siç janë të përcaktuara në licencë, si dhe ka të drejtën e rikthimit të gjitha kostove shtesë të shkaktuara si rezultat i kryerjes së këtyre detyrave.

3. Furnizuesi publik obligohet që të sigurojë informata të rregullta për konsumatorët e tij lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me furnizimin e tyre me energji termike, përfshirë informatat mbi lëndët djegëse, çështjet mjedisore dhe informatat për të drejtat e konsumatorëve në zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave.

Neni 20

Marrëveshjet kontraktuale dhe transaksionet

1. Furnizuesi publik dhe prodhuesit lidhin marrëveshje apo kontratë afatgjate për shitblerje të energjisë termike në kohëzgjatje që garanton furnizim të mjaftueshëm.

2. Marrëveshja apo kontrata për shitblerje afatgjate të energjisë termike përmban elementet si në vijim:

2.1. kohëzgjatjen e furnizimit;

2.2. kushtet teknike dhe kualitetin e furnizimit;

2.3. planin e furnizimit dhe pranimit;

2.4. përgjegjësinë për furnizim dhe pranim;

2.5. çmimin dhe elementet tjera financiare;

2.6. pagesën për furnizim; dhe

2.7. sanksionin për cenim apo mos përmbushje të kontratës.

3. Kontrata për shitblerje afatgjatë të energjisë termike lidhet për periudhën kohore prej një (1) deri në pesë (5) vite, me mundësi vazhdimi.

4. Kontratën, sipas këtij neni e miraton dhe e mbikëqyrë Zyra e Rregullatorit për Energji.

5. Furnizuesi publik lidhë kontratë me të gjithë konsumatorët përfshirë edhe konsumatorët fundorë për furnizim me energji termike në pajtim me rregullat e nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe në pajtim me nenin 25 të këtij ligji.

6. Transaksionet në mes të kategorive në vijim bëhen me çmime të rregulluara për:

- 6.1. prodhuesit, dhe furnizuesit publik në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;
- 6.2. furnizuesit publik dhe konsumatori fundor i kyçur në rrjetin e shpërndarjes;
- 6.3. furnizuesit publik dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, për të kompensuar shpenzimet teknologjike të transportit dhe shpërndarjes së energjisë termike dhe të humbjeve duke shfrytëzuar rrjetin përkatës të shpërndarjes.

7. Furnizuesi publik, për së paku pesë (5) vite, mban në dispozicion të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të gjitha transaksionet e kontratave për blerje të energjisë termike dhe për furnizim me energji termike, këto të dhëna u vihen në dispozicion, sipas kërkesës, Zyres së Rregullatorit për Energji dhe autoriteteve tjera relevante në pajtim me legjislacionin në fuqi.

8. Zyra e Rregullatorit për Energji ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar se informatat dhe të dhënat e ofruara janë të besueshme. Disa nga këto të dhëna dhe informata mund t'ju vihen në dispozicion pjesëmarrësve përkatës në sektorin e energjisë termike duke respektuar kushtet e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm komercial.

Neni 21

Rrjeti sekondar i energjisë termike

1. Ndërmarrja për energji termike mund të lidhë kontratë me konsumatorin e vet për instalim, servisim, mirëmbajtje dhe zgjerim të rrjetit sekondar prej daljes nga pika furnizuese.
2. Formati i kontratës dhe përmbajtja e saj miratohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
3. Ndërmarrja për energji termike mban dhe udhëheq kontabilitet dhe llogari rrjedhëse të ndara veç e veç për aktivitetet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 22

Përgjegjësia për sistemin sekondar

1. Administrimi i sistemit sekondar për energji termike në ndërtesa në shfrytëzim publik, apo privat bëhet nga administratori apo shoqata e pronarëve, që është përgjegjës për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të parregulluar prej pikës së furnizimit të sistemit sekondar, në pajtim me legjislacionin përkatës.
2. Nëse një ndërtesë që është në posedim të përbashkët apo të pjesshëm, pa themelim të administratorit apo shoqatës së pronarëve, ka disa shfrytëzues të energjisë termike, ndërmarrja ekzistuese për energji termike operon dhe mirëmban sistemin sekondar duke u bazuar në marrëveshjen e kontraktuar me banorët e ndërtesës, sipas tarifave që i përcakton Zyra e Rregullatorit për Energji.
3. Ndërmarrja për energji termike faturon ndaras shpenzimet për operim dhe mirëmbajtje të sistemit sekondar, sipas tarifave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Neni 23

Konsumatorët me prioritet furnizimi me energji termike

1. Furnizimi me energji termike për konsumatorët me prioritet furnizimi me energji termike mund të bëhet nga të gjithë personat që posedojnë licencë për furnizim me energjisë termike të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
2. Kushtet dhe afatet e licencës për furnizim të konsumatorëve me prioritet furnizimi me energji termike përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji, të cilat kërkojnë që furnizuesi të jetë subjekt financiarisht i qëndrueshëm dhe të posedojë kontrata për blerje të energjisë termike, që mbështesin aktivitetin e furnizimit.
3. Ndërmarrja e energjisë termike e licencuar për furnizim të konsumatorëve përveç bartësit të licencës për furnizim publik ka të drejtë:
 - 3.1. të furnizojë me energji termike konsumatorët me prioritet furnizimi me energji termike me çmime të parregulluara;
 - 3.2. të blejë energji termike nga prodhuesit me çmime të parregulluara;
 - 3.3. të blejë dhe t'ju shesë furnizueseve tjerë energji termike me çmime të parregulluara, si dhe të blejë energji termike nga furnizuesi publik në pajtim me dispozitat e nenit 18, 19 dhe 20 të këtij ligji; dhe
 - 3.4. të faturojë dhe arkëtojë pagesat nga konsumatorët me prioritet furnizimi me energji termike dhe nga furnizuesit tjerë.
4. Ndërmarrja e energjisë termike e licencuar për furnizim, e cila furnizon edhe konsumatorët me prioritet furnizimi me energji termike do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e konsumatorëve dhe ka për obligim të shqyrtojë me efektivitet të gjitha ankesat e konsumatorëve të saj. Shqyrtimi i ankesave monitorohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe ligjet e tjera të aplikueshme, si dhe me dispozitat përkatëse të licencës, kodeve dhe rregullave të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
5. Ndërmarrja e energjisë termike e licencuar për furnizim, e cila furnizon edhe konsumatorët me prioritet furnizimi me energji termike obligohet që të sigurojë informata të rregullta për konsumatorët e saj lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me furnizimin e tyre me energji termike, përfshirë informatat mbi lëndën djegëse, çështjet mjedisore dhe informatat për të drejtat e konsumatorëve në zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave.
6. Ndërmarrja e energjisë termike e licencuar për furnizim, e cila furnizon edhe konsumatorët me prioritet furnizimi me energji termike, për së paku pesë (5) vite, mban në dispozicion të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të gjitha transaksionet e kontratave për blerje të energjisë termike dhe për furnizim me energji termike, këto të dhëna u vihen në dispozicion, sipas kërkesës, Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe autoriteteve tjera relevante në pajtim me legjislacionin në fuqi.
7. Zyra e Rregullatorit për Energji ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar se informatat dhe të dhënat e ofruara janë të besueshme. Disa elemente nga këto të dhëna dhe

informata mund t'ju vihen në dispozicion pjesëmarrësve përkatës në sektorin e energjisë termike, duke respektuar kushtet e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm komercial.

8. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit përpilojnë ndaras listën e institucioneve që kanë përparësi të furnizimit të pandërprerë me energji termike.

Neni 24

Linjat direkte të tubacioneve

1. Ndërmarrjet e energjisë termike përkatësisht prodhuesit e energjisë termike, mund të lidhin stabilimentet e veta me stabilimentet e njësisë vartëse, apo stabilimentet e konsumatorëve përmes linjave direkte të tubacioneve, për t'i furnizuar me energji termike.
2. Të gjithë konsumatorët kanë të drejtë të furnizohen me energji termike përmes linjave direkte të tubacioneve për energji termike nga prodhuesi apo ndërmarrje tjetër për furnizim me energji termike, nëse kjo është e mundshme nga aspekti teknik dhe ekonomik.
3. Për kriteret e dhënies së autorizimit për ndërtimin e tubacionit të drejtpërdrejtë të energjisë termike, Zyra e Rregullatorit për Energji vendosë në mënyrë objektive dhe jodiskriminuese.
4. Zyra e Rregullatorit për Energji jep autorizimin për ndërtimin e linjave direkte të tubacioneve për energji termike në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
5. Nëse një konsumator furnizohet përmes linjës direkte të tubacionit, kjo nuk do të ndikojë në të drejtën e tij të kontraktimit të furnizuesit të zgjedhur dhe të pranimit të furnizimit përmes sistemit të shpërndarjes në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

KREU VII

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E KONSUMATORIT

Neni 25

Plotësimi i kushteve

1. Konsumatori që është i vendosur në zonën e shërbimit që mbulohet nga ndërmarrja e energjisë termike, ka të drejtë të furnizohet nëse i plotëson kushtet si në vijim:
 - 1.1. është pronar, ose i autorizuar të veprojë dhe të shfrytëzojë tërë apo vetëm një pjesë të rrjetit të brendshëm sekondar dhe t'i përmbushë kërkesat teknike dhe operative e të sigurisë;
 - 1.2. përmbushë kushtet për kyçje në rrjetin e shpërndarjes;
 - 1.3. ka nënshkruar marrëveshjen me shkrim me furnizuesin;
 - 1.4. ka siguruar qasje për vendosjen e pajisjes matëse të ngrohjes.

2. Konsumatori në zonën e mbuluar nga rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike ka të drejtë të jetë i kyçur, nëse janë plotësuar kushtet sipas kodeve përkatëse të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
3. Ndërmarrja e energjisë termike mund të refuzojë përkohësisht që të kyçë konsumatorin në sistemin e energjisë termike nëse konstaton se objekti, pajisjet apo rrjeti i shpërndarjes nuk i plotëson standardet teknike ose kushtet tjera sipas legjislacionit në fuqi, dhe ka arsyeshmëri ekonomike.
4. Konsumatori njoftohet me shkrim për shkaqet e refuzimit për kyçje, në sistemin e energjisë termike.
5. Nëse konsumatori bënë kyçje ilegale apo ndërhyrje të paautorizuar në sistemin e energjisë termike, atëherë ai bart përgjegjësi në pajtim me aktet ligjore përkatëse.
6. Nëse konsumatori me veprimet e parapara në paragrafin 5 të këtij neni i shkakton dëm Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është i obliguar që dëmin ta kompensojë.
7. Konsumatori është i obliguar të sigurojë hapësirë pa pagesë për vendosjen e pajisjeve të pikës së shpërndarjes dhe qasje të lirë të punëtorëve të ndërmarrjes së energjisë termike për kontrollimin e këtyre pajisjeve.
8. Konsumatori është i detyruar të sigurojë vendosjen e pajisjeve matëse të ngrohjes në hapësirat e brendshme, të banimit apo komerciale, për lexim nga distanca, dhe qasje të lirë të punëtorëve të ndërmarrjes së energjisë termike për kontrollimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve.

Neni 26

Kontrata dhe procedura e faturimit

1. Furnizimi i konsumatorit fundor me energji termike bëhet sipas kontratës të lidhur në pajtim me rregullat e miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
2. Konsumatori është i obliguar të paguajë faturat për energji termike, ndërsa procedura e faturimit, arkëtimit dhe sanksionet në rast mos pagese zbatohen sipas rregullave përkatëse.

Neni 27

Pezullimi i furnizimit shkycja dhe rikycja e konsumatorëve

1. Furnizuesi mund të pezullojë përkohësisht furnizimin e konsumatorit me energji termike në pajtim me rregullat dhe kodet përkatëse.
2. Furnizuesi lëshon një njoftim për ta informuar me shkrim konsumatorin për pezullimin e furnizimit. Njoftimi i tillë do të përshkruaj arsyen dhe kohëzgjatjen e pezullimit të furnizimit me energji termike dhe do t'i caktojë masat që do të ndërmerren për pezullimin e ndërprerjes së furnizimit.

3. Furnizuesi mund ta bëj pezullimin e përkohshëm të shërbimit për konsumatorin, nëse konsumatori nuk i përmbush obligimet që i ka në kontratë duke përfshirë riparimin e problemeve teknike që kanë ndodhur në rrjet dhe të pajisjeve matëse apo pajisjeve tjera të ngrohjes të instaluara brenda hapësirave të konsumatorit.
4. Shkyçja e përkohshme mund të zgjatë deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, nëse brenda këtij afati nuk eliminohen shkaqet që kanë sjellë shkyçjen e përkohshme, furnizuesi ka të drejtë të bëj shkyçjen e përhershme të konsumatorit dhe shpenzimet e kyçjes bien në barrë të konsumatorit.
5. Ndërmarrja e energjisë termike e rikyçë konsumatorin në sistemin e energjisë termike në afat prej tre (3) ditësh nga momenti i përmbushjes së obligimit dhe evitimit të shkakut të pezullimit.
6. Për konsumatorët, rregullat për pezullim do të specifikohen në kontratën e furnizimit me furnizuesin.
7. Nëse pezullimi i furnizimit të konsumatorit me energji termike bëhet pa fajin e konsumatorit, konsumatorit i kompensohet dëmi i konstatuar nga Komisioni përkatës i formuar nga ndërmarrja e energjisë termike.
8. Në rast të moskompensimit sipas paragrafit 7 të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Zyrën e Rregullatorit për Energji sipas ligji të Rregullatorit për Energji.

KREU VIII QASJA NË RRJETË

Neni 28 E drejta për qasje

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lejon çdo prodhues, furnizues apo konsumatorë të ketë qasje në sistemin e energjisë termike në bazë të akteve nënligjore të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon kushtet për qasje në rrejt dhe çmimet e tarifave të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Neni 29 Refuzimi i kërkesës

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojë kërkesën e konsumatorit për kyçje në sistemin e energjisë termike nëse mungon kapaciteti i nevojshëm për shpërndarje. Refuzimi i kërkesës për kyçje në sistemin e energjisë termike duhet të bëhet dhe arsyetohet me shkrim në afat prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita e paraqitjes së kërkesës për kyçje.

2. Personi që refuzohet për çfarëdo arsyeje të ketë qasje në rrjetin e energjisë termike ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e informimit me shkrim.
3. Ankesa i paraqitet Zyrës së Rregullatorit për Energji që është i obliguar të lëshojë vendim lidhur me ankesën në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të ankesës.
4. Nëse nuk lejohet qasje në rrjet të shpërndarjes për konsumatorët ose prodhuesit që dëshirojnë të lidhin kontratë me konsumatorët, atëherë ata mund të paraqesin kërkesë tek Zyra e Rregullatorit për Energji për lejim të ndërtimit të tubacionit të drejtpërdrejtë të furnizimit me energji termike.

KREU IX

MATJA DHE PAJISJET MATËSE

Neni 30

Pajisjet matëse

1. Furnizimi me energji termike matet me pajisje matëse ndërsa, instalimi, operimi, mirëmbajtja apo zëvendësimi i pajisjeve për matje, bëhet në pajtim me Kodin e Matjes.
2. Energjia termike e shfrytëzuar nga konsumatori llogaritet me pajisje për matje që është pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes
3. Tek konsumatorët fundor individual -objekte individuale të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në pikën e furnizimit, sa më afër kufirit të pronës së konsumatorit.
4. Tek konsumatorët fundor në ndërtesa kolektive - objekte kolektive të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në hapësirat e secilit konsumatorë, nëse është teknikisht e mundshme dhe leximi duhet të bëhet pa pasur qasje në hapësirat e banimit të konsumatorit.
5. Kufiri i pronës, përgjegjësia për objektet termike, vendi për vendosjen e pajisjeve matëse dhe të gjitha aspektet tjera të matjes përcaktohen me Kodin e Matjes.

KREU X KODET TEKNIKE

Neni 31 Rregullat teknike

1. Kodet sipas nenit 3 të këtij ligji, do të përmbajnë rregullat teknike që përcaktojnë projektimet minimale teknike, kërkesat operative dhe standardet për energji termike për:

1.1. kyçje të pajisjeve të konsumatorit në instalimet e sistemit të shpërndarjes dhe tubacionin e drejtpërdrejtë të energjisë termike;

1.2. strukturën e stacioneve të furnizimit me energji termike, pajisjeve dhe tubacionin e rrjetit;

1.3. menaxhimin e sistemit të energjisë termike,

1.4. mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes;

1.5. menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes;

1.6. matjen e energjisë termike, duke përfshirë parimet e matjes, njehsimit, mënyrën dhe vendndodhjen e njehsorëve pajisjeve për matje, afatet dhe procedurat për inspektim, kalibrim dhe lexim të njehsorëve, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave që përmbajnë të dhënat e regjistruara nga cilado pajisje komerciale për matje.

2. Kodet e përcaktuara sipas nenit 3 të këtij ligji përpilohen nga ndërmarrjet për energji termike, ndërsa miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

KREU XI MBIKËQYRJA

Neni 32 Mbikëqyrja dhe inspektimi administrativ

Mbikëqyrja administrative e zbatimit të këtij ligji dhe rregulloreve të nxjerra sipas këtij ligji kryhet nga Inspektorati i Energjisë i cili vepron në kuadër të Ministrisë.

Neni 33 Autorizimet e Inspektoratit të Energjisë

1. Nëse inspektorët në kryerjen e inspektimit konstatojnë se subjekti energjetik dështon në kryerjen e shërbimeve në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe standardet e zbatueshme të

kërkuara me kodet teknike, përveç kompetencave në pajtim me legjislacionin në fuqi, kanë autorizime:

1.1 të urdhërojnë heqjen e parregullsive të vërejtura dhe caktimin e afatit për eliminimin e tyre;

1.2. të ndalojnë ndërtimin e objektit të prodhimit në qoftë se nuk është marrë leja për ndërtim;

1.3. të urdhërojnë pezullimin e ndërtimit të mëtejshëm, gjegjësisht ndërprerjen e furnizimit me energji termike, apo shfrytëzimin e energjisë termike, nëse këto objekte nuk janë ndërtuar, nuk përdoren ose nuk mbahen në përputhje me dokumentet e miratuara ose certifikuara me rregulloret e veçanta teknike ose të tjera dhe për shkak të këtyre paraqitet një kërcënim i menjëhershëm për stabilitetin dhe sigurinë e objekteve energjetike, shëndetin apo jetën dhe sigurinë e trafikut ose ndërtesave ngjitur me këto objekte.

KREU XII DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 34 Gjobat

1. Me gjobë në shumë prej dymijë (2.000.00) deri dhjetëmijë (10.000.00) Euro do të gjobitet ndërmarrja e energjisë termike nëse:

1.1. kontraktin shitjen e energjisë termike me konsumatorët, pa pëlqimin e ndërmarrjes energjetike që kryen shpërndarjen e energjisë termike;

1.2. kryen shpërndarjen ose furnizimin me energji termike pa pasur licencë për këto aktivitete;

1.3. nuk arrin të ofrojë shërbime sipas kushteve dhe rregullave përkatëse dhe nuk shqyrton ankesat e konsumatorëve;

1.4. krijon dhe alokon kostot për prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë termike në kundërshtim me metodologjinë tarifore të përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

1.5. moslejtim të qasjes në rrjetin e shpërndarjes sipas kushteve të përgjithshme për furnizim me energji termike;

1.6. ka fituar të drejtën për kryerjen e aktiviteteve energjetike për shpërndarjen e energjisë termike, por nuk ka siguruar furnizim të sigurt të energjisë termike;

1.7. kryen shërbimet e furnizimit me energji termike pa lejen e Zyrës së Rregullatorit për Energji;

1.8. kyçë ndërtesën pa leje ndërtimi, apo ndonjë dokumenti relevant që lejon ndërtimin e atij objekti ndërtimor;

1.9. nuk vepron në pajtim me vendimin e inspektorit.

2. Me gjobë për kundërvajtje, në shumë prej treqind (300) deri njëmijë (1.000) Euro, do të gjobitet personi përgjegjës i ndërmarrjes së energjisë, i cili i ka shkelur dispozitat e këtij ligji.

3. Përveç gjobës monetare të shqiptuar, ndërmarrjes energjetike mund t'i ndalohe kryerja e aktiviteteve energjetike deri në një (1) vit, nëse brenda vitit ka kryer dy (2) apo më shumë shkelje të përcaktuara në këtë nen. Gjithashtu, personit përgjegjës të ndërmarrjes mund t'i ndalohe kryerja e aktiviteteve të njëjta deri në një (1) vit.

4. Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij neni kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KREU XIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Obligimi për instalimin e pajisjeve matëse dhe krijimi i raporteve komerciale

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon pajisje matëse për konsumatorë të kyçur në sistemin e energjisë termike brenda pesë (5) viteve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes blenë nga konsumatori pajisjet matëse, të cilat janë në pronësi të konsumatorit, në vlerë aktuale të tregut, brenda periudhës pesë (5) vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Nëse, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për arsye standardizimi dhe unifikimi instalon pajisjet e veta matëse për të zëvendësuar ato ekzistueset, nuk ka obligim për të blerë pajisjet sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4. Në pajtim me këtë ligj, krijohen raportet komerciale në mes furnizuesit dhe konsumatorit sipas akteve nënligjore të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

5. Furnizuesi përgatit dhe propozon kontratë komerciale për furnizim me energji termike të konsumatorit, sipas dispozitave të këtij neni dhe nenit 20 të këtij ligji dhe mbanë regjistrin e konsumatorëve dhe të të gjitha kontratave valide.

6. Në rast se kontrata për furnizim nuk lidhet brenda periudhës sipas këtij neni, me fajin e konsumatorit, furnizuesi bënë shkyçjen e tij, që në mënyrë të paligjshme furnizohet me energji termike.

7. Për konsumatorët që nuk kanë pajisje matëse, deri në instalimin e pajisjeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, aplikohet tarifa normative.

8. Nëse në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pika e furnizimit nuk është e pajisur me pajisje matëse, konsumatori i kyçur në pikën e furnizimit, faturohet sipas tarifës normative në përpjesëtim me totalin e sipërfaqes së objektit të konsumatorit.

9. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e instalimit të pajisjeve matëse nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në pikën e furnizimit, konsumatori që është i kyçur në këtë pikë furnizimi faturohet sipas tarifës së energjisë së shpenzuar në vitin kur është instaluar matësi.

10. Në objektet me më shumë konsumator individualë të energjisë termike, faturimi i konsumatorëve individualë për konsumin e matur në pikën e furnizimit, bëhet në përpjesëtim me sipërfaqen e banimit të secilit konsumatorë fundor.

11. Në objektet e reja instalimi i energjisë termike projektohet për çdo banesë e lokal afarist ndarazi. Për këtë përkujdesen institucionet përkatëse që lëshojnë leje ndërtimi.

Neni 36 Dispozitat kalimtare

1. Dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha aktet nënligjore, vendimet, rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas Ligjit Nr. 03/L-116 për Ngrohjen Qendrore, duhet të harmonizohen me këtë ligj.

2. Ministria dhe Zyra e Rregullatorit për Energji, për zbatim të këtij ligji, do të nxjerrin aktet nënligjore në afat prej gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 37 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr.03/116 për Ngrohjen Qendrore

Neni 38 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -052
14 dhjetor 2015**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI